

VENDIM
Nr.27, datë 19.7.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Halil Kopani,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, më datën 11.7.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.37 Akti që i përket:

KËRKUESE: PARTIA SOCIALISTE, e përfaqësuar nga Z.Bashkim Caka dhe Vladimir Metani.

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga sekretari, Z. Thimjo Kondi.

O B J E K T I:

Anulimin e vendimit nr.1280, datë 7.7.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zonën 61, sipas nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor".

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi shqyrtoi pretendimet dhe provat e kërkuarit, subjektin e interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Sipas procesverbalit të komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.61, datë 1.7.1997, rezulton se ka fituar kandidati i Partisë Demokratike. Vendimi i këtij komisioni është lënë në fuqi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.1280, datë 7.7.1997.

Pala kërkuare ka kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke pretenduar se:

Nuk janë patur parasysh dhe nuk janë llogaritur rezultatet e pesë qendrave të votimit dhe konkretisht ato me nr.25, 28, 29, 31 dhe 32; ka patur presione në qendrat e votimit nr.2, 4 e 27 të fshatrave Sfilë, Greth, Kazije, Damës e Sharrdushk, procesvrablet janë fiktive.

Gjykata mori parasysh dhe llogariti edhe rezultatet e 5 qendrave të votimit që nuk ishin patur parasysh nga komisioni i zonës dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe përsëri rezultati doli po në favorin e kandidatit që kishin pranuar komisionet.

Gjithashtu mori në shqyrtim dhe analizoi edhe shkaqet e tjera dhe konstatoi se mungonin vërejtjet nëpër procesverbalet si e kërkon ligji.

Në përfundim konkludohet se nuk ka vend për pranimin e kërkesës as dhe për balotazh.

P Ë R K Ë T O A R S Y E

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 e vijues të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor", njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 19.7.1997

